

Njoftim i përqendrimit me të cilin DULUHGRUP LIMITED nga Australia do të fitoj kontrollin e vetëm të drejtpërdrejtë mbi N.P.T. S.R.L. nga Italia

(lënda nr. 08-42 /2023)

Në bazë të nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 23.02.2023, në Komisionin për mbrojtjen e konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit të vetëm të drejtpërdrejtë nga DULUHGRUP LIMITED me seli në rr. Dandenong Nr. 1956, Klejton, Viktoria 3168, Australi mbi N.P.T. S.R.L. me seli në Via Guido Rossa nr.2, Valsamoglia (BO) nëpërmjet shitblerjes së pjesëve.

- **DULUHGRUP LIMITED** është një shoqëri që prodhon dhe tregon, kryesisht në Australi dhe Zelandën e Re, bojëra dekorative, ngjyrë me teksturë, ngjyrë mbrojtëse, ngjyrë industriale, ngjyrë pluhuri dhe ngjyrë për kujdesin e drurit për shtëpitë ekzistuese, ndërtime të reja banimi, ndërtime komerciale, infrastrukturë dhe tregje industriale. DULUHGRUP LIMITED kontrollohet tërësisht nga Nippon Paint Holdings Ko. Ltd, një shoqëri holding japoneze e cila ka aktivitete në industrinë e bojërave dhe veshjeve .

DULUHGRUP LIMITED ka një shoqëri të regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përkatësisht Shoqërinë për tregti dhe shërbime JUB SHPKNJP Shkup me seli në bul. Jane Sandanski nr.79A-3, Shkup dhe aktiviteti i regjistruar prioritar-tregtia me shumicë e produkteve kimike.

- **N.P.T. S.R.L.** është njëshoqëri që është aktive kryesisht në Itali dhe Evropë. Shoqëria e synuar është në pronësi të plotë të 3G Group S.p.A. dhe është aktive në prodhimin dhe shitjen e ngjitësve.

N.P.T. S.R.L. ka qarkullim të kufizuar në Maqedoni dhe nuk është e pranishme në vendin tonë.

Parashtruesi i njoftimit i propozon komisionit si treg relevant të merret tregu i ngjitësve.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

27.02. 2023

Shkup